



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 62, datë 30.06.2020

PËR
MIRATIMIN E KRYERJES SË SHËRBIMIT TË PASTRIMIT TË NJËSISË
ADMINISTRATIVE SUKTH NGA OPERATORËT EKONOMIK

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit Ministrave nr.319, datë 21.6.1994 “Për prokurimin me sipërmarrje të shërbimeve publike të pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave”, Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.306, datë 01.12.2015 “Për miratimin e kalimit të shërbimit të pastrimit në territorin e Bashkisë Durrës me sipërmarrje private” dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve dhe Drejtoria e Buxhetit, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,


KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e kryerjes së shërbimit të pastrimit të Njesisë Administrative Sukth nga Operatorët Ekonomik.
2. Fondit vjetor i parashikur për mbulimin e shërbimit të pastrimit në Njësinë Administrative Sukth nga Operatorët Ekonomik është 22.000.000 lekë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe e Punëve Publike, Drejtoria e Buxhetit dhe Njësia e Prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 02.07.2020




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 589 prot.



Durrës, më 06.07 .2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.62 datë 30.06.2020 “Për miratimin e kryerjes së shërbimit të pastrimit të njësisë administrative Sukth nga operatorët ekonomik”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

